

**AKT THEMELIMI**  
**Për krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar**  
**“MARA 2024” SH.P.K.**

Sot, më datën 09/04/2024, **Z. FLORI MARA** i lindur në Tepelene, Shqiperi më datë 23 Prill 1987 mbajtës i leternjoftimit me numër personal I70423048E, banues në Durrës, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, vendosi të themelojë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar “**MARA 2024**” Sh. P. K. si më poshtë vijon:

**Neni 1**

Individi i sipërpërmendur, me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar, krijon shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar (Sh.P.K.) me emërtimin “**MARA 2024**” shpk.

Ortak i kësaj shoqërie është **Z. FLORI MARA**.

Administrator i kësaj shoqërie caktohet **Z. FLORI MARA**, shtetas shqiptar, lindur ne Shqiperi me 23 Prill 1987, i pajisur me NID nr. I70423048E. Z.Mara emerohet administrator i shoqerise per nje periudhe 5 vjecare.

Shoqëria ka të drejtë të krijojë filiale të saja brenda dhe jashtë vendit në çdo kohë që do të vlerësohet e arsyeshme prej saj dhe me aprovimin e organeve kompetente.

**Neni 2**

Shoqëria “**MARA 2024**” SH.P.K gëzon statusin juridik të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “**Sh.P.K.**”. Veprimtaria e saj do të zhvillohet sipas dispozitave të kësaj kontrate, statutit të saj dhe legjislacionit në fuqi.

Selia e shoqërisë “MARA 2024” SH.P.K. është: **Durrës, Rr. A.Goga 18, 30/223-N18.**

Statuti i shoqërisë i bashkangjitet këtij akti themelimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Shoqëria ka vulën e saj me logon dhe të dhënat të përcaktuara.

**Neni 3**

Veprimtaria e shoqërisë si person juridik fillon me aprovimin e krijimit të saj nga organet kompetente të shtetit dhe do të vazhdojë për një periudhë kohe pa afat të përcaktuar.

**Neni 4**

Shoqëria do të kryejë aktivitetet me objekt:

- Qiradhenie e automjeteve te te gjitha llojeve, ngritja e rrjetit te qiradhenies se automjeteve ne te gjithë territorin e Republikës se Shqiperise.
- Dhenia e automjeteve te te gjitha Llojeve me qira financiare. Ofrim sherbim taksie.
- Import eksport te produkteve gjithëfaresh (automjete, pjese kembimi, pajisje elektroshtepiake, produkte elektrike, goma, vegla pune ) etj.
- Shitje me shumice e pakice e te gjitha llojeve te automjeteve dhe mjeteve te tjera te transportit si dhe makineri te ndryshme pune.
- Sherbime imobiliare
- Sherbime ndermjetesimi



- Organizimi i nje rrjeti njesish tregtare dhe riparuese te cilat do ushtrojne veprimtarine e tyre ne perputhje me veprimtarine kryesore.

#### **Neni 5**

Kapitali i shoqerise eshte 100.000 Leke. Kapitali i shoqerise ndahet ne nje numer kuotash ne raport me kontributin e dhene nga cdo ortak ne shoqeri ku cdo ortak zoteron nje kuote te vetme ne shoqeri, kuota keto te shlyera si me poshte:

- **Z. FLORI MARA** zotërues i një kuote me vlerë të përgjithshme 100.000 leke që përbën 100% të kapitalit të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve mund te jete ne para ose ne natyre (pasuri te luajtshme ose te paluajtshme apo te drejta). Ortaket pergjigjen per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

#### **Neni 6**

Fitimi neto nga aktiviteti i kësaj shoqërie i përket ortakëve të saj.

#### **Neni 7**

Për detyrimet që do të krijohen ndaj personave të tretë gjatë aktivitetit të kësaj shoqërie do të përgjigjet vetë shoqëria deri në kufirin maksimal të kapitalit të saj.

#### **Neni 8**

Marrëdhëniet e punës në shoqëri dhe në filialet e saj rregullohen nëpërmjet kontratës së punës.

#### **Neni 9**

Dispozita të hollësishme mbi organizimin e kësaj shoqërie përcaktohen në statutin e saj. Themeluesit e kësaj shoqërie, pasi e lexuan me vëmendje këtë akt themelimi dhe e gjetën në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me vullnetin e tyre, e firmosën pa vërejtje.

### **ORTAKU I VETEM I SHOQERISE**

**FLORI MARA**

